



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA A REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planimar / Dorezimi Primitje/Prodato Received/Delivery	09.08	2022	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	In Prof In Prof Prof.No	Shitja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHI 4615/2022			1/3



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.571/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: , Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani - anëtar, me Zyle Millaku Gojnovci -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit për shqyrtimin e ankesës A.nr.571/2022 të datës 27.06.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë në Komunë të Suharekës, kundër organit të punësimit Komuna e Suharekës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 08.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, SHPALLET jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.571/2022 të datës 27.06.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i emëruar sipas Vendimit nr.016-39152 të datës 30.06.2022 në vendin e punës "Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim", në Komunë të Suharekës, ka parashtruar ankesë me datë 27.06.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 016-35921 të Komisionit Disiplinor të datës 16.06.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 01.07.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Komunë të Suharekës, ndërsa Këshilli, më datë 13.07.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës prej 1/11 faqe.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesa A.nr.571/2022, e datës 27.06.2022, me numër protokollit 3725/2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për





Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimit nr.016-39152 të datës 30.06.2022 i Kryetarit të Komunës; Aktvendimi nr.016-35921 i Komisionit Disiplinor i datës 16.06.2022; Kërkesë për plotësim të lëndës e datës 20.05.2022; E-mail i datës 17.05.2022; Përgjigje e datës 24.05.2022; Përgjigje në ankesë e datës 13.07.2022; Vendim i datës 16.03.2022; Kërkesë e datës 31.05.2022; e-mail i datës 06.06.2022; Kërkesë për prova shtesë drejtuar nga KPMSHCK-së; Prove shtesë e datës 02.08.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi **sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka shqyrtuar ankesën e ankuesit të datës 27.06.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 016-35921 të Komisionit Disiplinor të datës 16.06.2022, gjegjësisht pretendimet ankimore se Komisioni Disiplinor me rastin e pezullimit të procedurës disiplinore ka vepruar në kundërshtim me ligjin në fuqi, sepse nëpunësi civil A.A, e ka sulmuar personin zyrtar në vendin e punës dhe se njoftimi i policisë se është iniciuar kallëzim penal ndaj sulmuesit nuk ka qene arsye bindëse të pezullohet procedura disiplinore .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit konkretisht përgjigjen në ankesë të datës 13.07.2022 të Komunës së Suharekës si dhe provat shtesë të dërguara përmes e-mailit të datës 03.08.2022, ka konstatuar se ankuesi me Vendimin nr.016-39152 të datës 30.06.2022, është i emëruar në vendin e punës "Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim", në Komunën e Suharekës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke ju referuar nenit 2 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se zyrtarët publikë ndahen në: *nëpunës të Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunësi i Shërbimit Publik; nëpunësi i Kabinetit; dhe nëpunës administrativ dhe mbështetës*, si dhe duke ju referuar Vendimit nr.016-39152 të datës 30.06.2022, me të cilin ankuesi është emëruar në vendin e punës "Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim", në Komunën e Suharekës, konstaton se të zgjedhurit apo të emëruarit në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk i takojnë shërbimit civil respektivisht janë kategorizuar si funksionarë publikë ashtu siç përcaktohet me nenin 3 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 ku përcaktohet se: „1. Ky ligj nuk zbatohet për: 1.1. funksionarët publikë.....; 1. 2. Funksionarë publikë, në kuptimin e nën paragrafit 1.1 të këtij neni, janë.....: 2.1. të zgjedhurit“. Andaj, duke marrë parasysh se ankuesi tanimë me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë nuk e ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur për funksionarët publikë

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli shqyrton dhe merr vendime për *ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil*, si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil apo të kandidatit për pranim në shërbimin civil, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.571/2022 të datës 27.06.2022 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.571/2022

Zyle Millaku-GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesi
- Kryetarit të Komunes së Suharekës ;
- Udhëheqëses së Burimeve në Komunës së Suharekës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

